

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Asfaltim i objekte të investimeve dhe mirëmbajtje”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime shtrimi dhe asfaltimi 45233222-1 Shërbime Mirembajtje 98341110-9

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): **REF-89213-06-08-2026**

FONDI LIMIT: 19.987.899 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë)

Argumentimi: Bazuar në preventivin e përlloritur mbështetur në VKM Nr.629, date 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, (te ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (te ndryshuar) autoriteti/enti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim x

Bazuar në pikën 3, neni 45 të VKM 285 datë 19.05.2021 ku autoriteti mund të mbështetet në ofertën ekonomikisht më të favorshme të bazuar në çmim.

Duke qenë se natyra e punës është e tillë që është lehtësisht e gjendur në treg është zgjedhur si mënyrë vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme e bazuar në çmim.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3; në vlerën 2% të fondit limit: 399.757,98 (treqind e nentëdhjetë e nente mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtate mijë presje nentëdhjetë e tete) Lekë Pa TVSH*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kritereve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024,2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne Ligjin Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshem gjatë 3(tre) viteve të fundit 2023, 2024,2025 Pasqyrat financiare vjetore (bilancet) të parqiten konform parashikimit të **nenit 41** të Ligjit Nr. 10091, date 05.03.2009. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqesë kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit, të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

***Argumentimi:** Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43; pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006) “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026).**

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, përkatësisht jo më e vogël **9.993.949,5 (nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë presje pesë) lekë pa t.v.sh.**

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne orgamet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe natyra e punes se bere,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe natyra e punes se bere,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

50% 19,987,899 = 9.993.949,5

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga MPPT/MTI , e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1A Punime gërmimi në tokë
- b. NP-4A Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tranvai, metro, pista , o aeroportuale.
- c. NP-7 A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se

kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinë duke u bazuar ne ekuivalentimin e licencave profesionale të huaja që disponojnë nga vendi i origjinës sipas parashikimeve të rregullores së miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinë duke u bazuar ne ekuivalentimin e licencave profesionale të huaja që disponojnë nga vendi i origjinës sipas parashikimeve të rregullores së miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008 “Për kriteret dhe

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në Vendimin Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë për ekuivalentimin e licencës së huaj në Republikën e Shqipërisë.

NP-1A – Punime gjurmimi në tokë

Argumentim:Kërkesa për licencën NP-1A është e justifikuar pasi realizimi i punimeve të asfaltimit dhe rehabilitimit rrugor përfshin procese paraprake gjurmimi, heqje të shtresave ekzistuese, hapje kanalesh për sistemime dhe përgatitje të nënshtresave. Kjo kategori licence garanton që operatori ekonomik disponon kapacitet teknik dhe profesional për realizimin e punimeve të gjurmimit në përputhje me specifikimet teknike dhe normat e sigurisë, duke siguruar stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e shtresave rrugore.

NP-4A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale

Argumentim:Licenca NP-4A është thelbësore pasi objekti i prokurimit konsiston në punime asfaltimi dhe ndërhyrje në infrastrukturë rrugore. Kjo kategori licence certifikon se operatori ekonomik ka eksperiencën, kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e punimeve rrugore sipas standardeve kombëtare dhe teknike në fuqi. Përmes kësaj licence garantohej cilësia, siguria dhe jetëgjatësia e investimit publik.

NP-7A – Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje

Argumentim:

NP-7A kërkohet pasi objekti i kontratës për asfaltim përfshin edhe punime të lidhura me sistemin e kullimit dhe infrastrukturën nëntokësore. Gjatë zbatimit të punimeve parashikohen ndërhyrje për sistemimin e ujërave sipërfaqësore, rehabilitimin e pusëve dhe elementëve të drenazhimit, si dhe mbrojtjen apo përshtatjen e rrjeteve ekzistuese të ujësjiellësit dhe infrastrukturave të tjera nëntokësore. Këto procese janë të domosdoshme për garantimin e stabilitetit të trupit të rrugës dhe jetëgjatësisë së shtresave asfaltike. Për këtë arsye, kërkesa për licencën NP-7A konsiderohet e lidhur ngushtë me natyrën e punimeve dhe e nevojshme për realizimin cilësor të objektit të kontratës.

2.3.3. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, si më poshtë:

(1) inxhinier Ndertimi

(1) inxhinier Hidrolog

(1) inxhinier Gjeolog

(1) inxhinier Mjedisi

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky kriter është vendosur bazuar edhe në volumin e punimeve si dhe në zërat e preventivit.

Bazuar ne natyren e punes qe do te kryhet per realizimin e objektit, specifikimeve teknike dhe zerave te preventivit operatori duhet te kete informacion te nevojshem lidhur me te dhenat qe kerkon projekti sipas sipas specifikimeve teknike.

Cilesia e punes duhet te jete e tille qe te arrihen standartet e kerkuara dhe te plotesoje kushtet teknike te zbatimit ne fuqi githashtu dhe afatet kohore te percaktuara ne projekt.

(1) Inxhinier Ndërtimi

Kërkesa për një Inxhinier Ndërtimi është e domosdoshme për drejtimin teknik, organizimin dhe mbikëqyrjen e punimeve të asfaltimit dhe shtresave rrugore. Ky specialist garanton zbatimin korrekt të projektit, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe respektimin e specifikimeve teknike, si dhe koordinimin e proceseve të punës në terren. Prania e tij siguron realizimin e punimeve në përputhje me standartet teknike dhe normat e sigurisë në fuqi.

(1) Inxhinier Hidrolog:*Punimet e asfaltimit dhe rehabilitimit rrugor lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e ujërave sipërfaqësore dhe sistemet e kullimit. Kërkesa për një Inxhinier Hidrolog justifikohet me nevojën për analizimin e kushteve hidrologjike, projektimin ose verifikimin e zgjidhjeve të drenazhimit dhe parandalimin e dëmtimeve të shtresave rrugore nga infiltrimi apo grumbullimi i ujërave. Ky specialist garanton qëndrueshmërinë afatgjatë të infrastrukturës.*

(1) Inxhinier Gjeolog:*Për realizimin korrekt të punimeve të gërmimit dhe ndërtimit të shtresave rrugore, është e nevojshme vlerësimi i karakteristikave gjeologjike dhe gjeoteknike të terrenit. Inxhinieri Gjeolog siguron analizën e kushteve të tokës, stabilitetin e nënshtresave dhe përcaktimin e masave përforcuese kur është e nevojshme. Kjo minimizon riskun e deformimeve, çarjeve apo dëmtimeve të mëvonshme të asfaltit.*

(1) Inxhinier Mjedis :

Punimet e asfaltimit kanë ndikim në mjedis, përfshirë menaxhimin e mbetjeve inerte, kontrollin e pluhurave dhe respektimin e kushteve mjedisore gjatë zbatimit të kontratës. Kërkesa për një Inxhinier Mjedis garanton monitorimin e masave mbrojtëse, zbatimin e legjislacionit mjedisor dhe minimizimin e ndikimeve negative në zonën e ndërhyrjes. Kjo siguron realizimin e projektit në përputhje me standartet e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakinist dhe një eskavatorist.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Shënim: Operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit (kontratën e punës, dëshminë përkatëse, **kontratë shërbimi, marrëveshje bashkëpunimi ose çdo formë tjetër e lejuar nga legjislacioni në fuqi.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mesiperme janë të mbeshetura në zërat e punimeve që janë parashikuara në preventiv si edhe në krijimin e besueshmerisë së AK në zotërimin e kualifikimeve të nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, makinerite apo pajisje të tjera asetë fizike të nevojshme për të zbatuar kontratën ku autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për personelin kryesor që ka në dispozicion OE, duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësitë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës për të krijuar besueshmerinë publike nga OE për realizimin me efikasitet dhe efikasitet të kontratës.

Kjo kërkesë justifikohet me natyrën e punimeve të objektit të prokurimit, i cili përfshin procese gjurmimi, sistemimi të nënshtresave, transporti i materialit dhe shtrirje të shtresave asfaltike, që realizohen përmes përdorimit të mjeteve të rënda ndërtimore.

Prania e një automakinisti është e domosdoshme për operimin e mjeteve transportuese dhe makinerive të shtrimit, ndërsa eskavatoristi është i nevojshëm për realizimin e gjurmimeve, sistemimeve dhe përgatitjes së terrenit para asfaltimit.

Kjo kërkesë është proporcionale me objektin e kontratës dhe garanton që operatori ekonomik ka kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e punimeve në mënyrë cilësore, brenda afateve dhe në përputhje me standardet e sigurisë në punë.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(një) Mjek, të vërtetuar me kontratë noteriale shërbimi me afat vlefshmerie brenda afatit të zbatimit të punimeve, Diplomë, License për ushtrimin e profesionit

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë 1 mjek me Kontratë. Nuk është kusht që mjeku të jetë i siguruar.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

Kriteri i mësipërm është vendosur duke I’u referuar VKM-së Nr. 692, datë 13.12.2001 “PËR MASAT E VEÇANTA TË SIGURIMIT DHE MBROJTJES SË SHËNDETIT NË PUNË” neni 12/2 “Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës”

Kërkesa që operatori ekonomik ofertues të disponojë 1 (një) mjek është e bazuar në detyrimet e përcaktuara në VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 06.11.2003, e cila parashikon detyrimin e punëdhënësit për sigurimin e mbikëqyrjes mjekësore për punëmarrësit që ushtrojnë veprimtari me risk.

Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimore dhe asfaltimi, të cilat realizohen me makineri të rënda, procese gjermimi dhe punë në ambient të hapur, me ekspozim ndaj temperaturave të larta, pluhurit dhe faktorëve të tjerë të rrezikut profesional. Këto elemente rrisin probabilitetin e aksidenteve në punë, lëndimeve mekanike, problemeve respiratore apo goditjeve nga nxehtësia.

Duke qenë se punimet kërkojnë angazhimin e një numri të konsiderueshëm punonjësish, rezulton e nevojshme dhe proporcionale sigurimi i mbikëqyrjes mjekësore gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Prania e mjekut garanton monitorimin periodik të gjendjes shëndetësore të punonjësve, këshillimin për masat parandaluese dhe reagimin e menjëhershëm në raste emergjence.

Kjo kërkesë nuk përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës, pasi parashikohet përmes kontratës së shërbimit, por përfaqëson një masë të domosdoshme për respektimin e legjislacionit në fuqi dhe garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **20 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Operatori ekonomik i kualifikuar, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për 3 muajt e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për 3 muajt e fundit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Llogaritja e numrit të punëtorëve është bërë bazuar në vëllimin e punimeve që do të kryhen sipas preventivit të punimeve në zbatim të VKM Nr 629 datë 15.07.2015, Për Miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre.

Praktikisht : Vëllimi i punimeve në leke: Pagën orare: orë/ditë: ditëpunë/muaj: afatin kohor të punimeve = Nr i punëtorëve.

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 20 (tridhjetë) personash. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Kjo kërkesë është përcaktuar në funksion të volumit të punimeve të parashikuara në preventiv, fondit limit prej 19,987,899 lekë dhe afatit të realizimit të kontratës prej 12 muajsh. Objekti i prokurimit përfshin punime gërmimi, sistemim terreni, shtresa rrugore, asfaltim dhe punime shoqëruese infrastrukturore, të cilat kërkojnë organizim të strukturuar teknik dhe operacional.

Për realizimin e punimeve brenda afatit kontraktual dhe në përputhje me specifikimet teknike, është e nevojshme zhvillimi paralel i disa proceseve të punës, çka presupozon disponimin e një kapaciteti minimal të qëndrueshëm njerëzor. Numri prej 30 punonjësish përfaqëson kapacitet bazë operacional për ndarjen e ekipeve sipas zërave të punimeve dhe garanton vijueshmërinë e proceseve pa ndërprerje për mungesë personeli.

Ky kriter konsiderohet proporcional me natyrën, vlerën dhe kohëzgjatjen e kontratës dhe nuk përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës, por synon të garantojë realizimin cilësor dhe në kohë të punimeve, në përputhje me parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) punonjës që të disponojë certifikatë si "Përgjegjes për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M / nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Në rastin e bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të disponojë punonjësin, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësit të mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.

Operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues (kontratën e punës, diplomën përkatëse si dhe listëpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.”.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht bazuar në ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Kjo kërkesë është e bazuar në legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë, i cili parashikon detyrimin e punëdhënësit për të garantuar organizimin dhe zbatimin e masave parandaluese në vendin e punës, veçanërisht në kantieret e ndërtimit.

Objekti i kontratës përfshin punime ndërtimore dhe asfaltimi, që realizohen me makineri të rënda, procese gjermimi dhe operime në ambient të hapur, elementë që paraqesin rrezik të shtuar për aksidente dhe dëmtime në punë. Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë një person të kualifikuar dhe të certifikuar, i cili të jetë përgjegjës për: Hartimin dhe monitorimin e planit të sigurisë në kantier; Identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve; Zbatimin e masave parandaluese dhe mbrojtëse; Mbikëqyrjen e respektimit të rregullave të sigurisë nga punonjësit.

Kjo kërkesë është proporcionale me natyrën e punimeve dhe nuk përbën kufizim të pajustificuar të konkurrencës, por synon garantimin e kushteve të sigurta të punës dhe respektimin e detyrimeve ligjore në fuqi.

2.3.8 Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së punimeve:

- Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën e cilesisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (Sistemi I menaxhimit të cilesisë) ose ekuivalent me të (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve

ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

- Shoqëria duhet të paraqesë Certificate **ISO 14001-2015** (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) (e vlefshme) ose ekuivalente me të. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- Shoqëria duhet të paraqesë certifikatë **ISO 45001:2018** (*Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë*) (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

ISO 14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

ISO 45001:2018 është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve objekt kontrate, të cilat përfshijnë procese ndërtimore dhe asfaltimi me përdorim makinerish të rënda, punime në terren dhe ekspozim ndaj faktorëve të rrezikut profesional.

ISO 45001:2018 garanton që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem të strukturuar për: Identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve në vendin e punës; Zbatimin e masave parandaluese; Monitorimin e kushteve të sigurisë në kantier; Përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në sigurinë dhe shëndetin në punë.

Kjo kërkesë është proporcionale me objektin e kontratës dhe synon të sigurojë që operatori ekonomik disponon standarde të certifikuar ndërkombëtarisht për menaxhimin e sigurisë në punë, duke reduktuar riskun e aksidenteve dhe duke garantuar respektimin e legjislacionit në fuqi.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të disponojë fabrikë ose kontratë qeraje ose **kontrate furnizimi** të përpunimit të asfaltit me vendodhje 5-10 Km larg në rrugë tokësore nga Sheshi Skenderbej, Qyteti i Tiranës.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik të cmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre “(perlllogaritja e oreve të punes si edhe të mjeteve të nevojshme) , Kodi i Punes në RSH , si edhe bazuar në dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt të objektit.

Kerkesat e mesiperme janë të mbeshetura në zërat e punimeve që janë parashikuara në preventiv si edhe në krijimin e besueshmerise së AK në zoterimin e kualifikimeve të nevojshme teknike, profesionale , kapacitetet organizative , aftesite organizative, makinerite apo pajisje të tjera asetë fizike të nevojshme për të zbatuar kontratën ku autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për personelin kryesor që ka në dispozicion OE , duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftesite zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës për të krijuar besueshmerine publike nga OE për realizimin me efikasitet dhe eficence të kontratës.

Punimet e asfaltimit kërkojnë furnizim të vazhdueshëm me përzierje bituminoze, e cila duhet të transportohet dhe të shtrohet brenda intervalit kohor dhe temperaturës së përcaktuar në specifikimet teknike, në mënyrë që të mos cenohet cilësia dhe qëndrueshmëria e shtresës asfaltike.

Distanca e arsyeshme e impiantit nga kantieri është një element teknik thelbësor për:

- Ruajtjen e temperaturës optimale të asfaltit gjatë transportit;
- Shmangien e humbjes së parametrave fizikë;
- Garantimin e cilësisë së shtresës përfundimtare
- Vijueshmërinë e pandërprerë të procesit të shtrimit.

Kjo kërkesë nuk synon kufizim territorial, por garantimin e cilësisë së materialit dhe realizimin korrekt të punimeve, në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet për asfaltimin

2.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te disponoje leje mjedisi tipi B “Per mbrojtjen e mjedisit:

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar e bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Kërkesa që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të disponojnë **leje mjedisi tipi B** bazohet në legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit, konkretisht në Ligji Nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar.

Leja e mjedisit tipi B është e detyrueshme për subjektet që zhvillojnë aktivitete me ndikim të konsiderueshëm në mjedis, por jo në nivelin më të lartë të rrezikut. Kjo leje garanton që operatori: Ushtron aktivitetin në përputhje me standardet mjedisore në fuqi, Ka marrë masa për parandalimin dhe minimizimin e ndotjes, Monitoron dhe kontrollon ndikimet në ajër, ujë dhe tokë, Zbaton kërkesat për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e shëndetit publik

Vendosja e kësaj kërkesë në dokumentet e tenderit synon të sigurojë që operatorët ekonomikë janë të pajisur me kapacitetet dhe përgjegjshmërinë e nevojshme për të realizuar kontratën pa shkaktuar dëme në mjedis, si dhe të garantojë përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe standardet e qëndrueshmërisë.

2.3.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Fadrome	1	Pronesi ose me qera
Kamion me vinc minimum 10 (dhjetë) ton dhe maksimumi – 20 (njetetë) ton për secilin kamion	1	Pronesi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës) minimum 12 (dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 22 (njetete e dy) ton për secilin kamion	1	Pronesi ose me qera
Asfaltoshtruese	2	Pronesi ose me qera
Rrul	2	Pronesi ose me qera
Makineri sperkatje bitumi	1	Pronesi ose me qera
Freze asfalti	1	Pronesi ose me qera

Bobcat me zinxhir	1	Pronesi ose me qera
Minieskavator	1	Pronesi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi – 20 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kullë ndricimi — 1 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt - minimumi 15 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(të vlefshme) Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shogqërohet me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që Vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sh.a (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi).

Për përmbushjen e këtij kriteri , operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formualrin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin e provues për makineritë e mësipërme.

Shënim: OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas VKM nr. 629, date 15.07.2015 “Per miratimin e manualit teknik te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre “(perllogaritja e oreve te punes si edhe te mjeteve te nevojshme) , Kodi i Punes ne RSH , si edhe bazuar ne dosmosdoshmerine e realizimit sa me shpejt te objektit.

Kerkesat e mesiperme jane te mbeshtetura ne zerat e punimeve qe jane parashikuara ne preventiv si edhe ne krijimin e besueshmerise se AK ne zoterimin e kualifikimeve te nevojshme teknike, profesionale , kapacitetet organizative , aftesite organizative, makinerite apo pajisje te tjera asetete fizike te nevojshme per te zbatuar kontraten ku autoriteti kontraktor kerkon deshmi per personelin kryesor qe ka ne dispozicion OE , duke qene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesite zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates per te krijuar besueshmerine publike nga OE per realizimin me efikasitet dhe eficence te kontrates.

Referuar natyrës të punimeve të përcaktuara në preventiv të administruar në dosjen e procedurës është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të dëshmojnë, mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, makinerit e nevojshme mbi realizimin me sukses të punës sipas specifikimeve dhe projektit i cili i është bashkelidhur DST.

Argumentim mbi Specifikimet Teknike

Specifikimet teknike të përcaktuara në këtë dokument janë hartuar në përputhje me standardet kombëtare në fuqi (STASH) dhe praktikat e konsoliduara të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore. Qëllimi i tyre është garantimi i cilësisë, qëndrueshmërisë, sigurisë dhe jetëgjatësisë së shtresave asfaltike që do të realizohen në kuadër të kontratës.

Përcaktimi i klasifikimit të asfaltobetonit sipas madhësisë së kokrrizës, përbërjes granulometrike dhe përqindjes së bitumit është thelbësor për arritjen e parametrave mekanikë të kërkuar, si rezistenca në shtypje, qëndrueshmëria ndaj temperaturave të larta, rezistenca ndaj ujit dhe kontrolli i porozitetit. Respektimi i kërkesave të STASH 660-87, STASH 539-87 dhe standardeve të tjera përkatëse siguron që materialet përbërëse (bitumi, agregatet, pluhuri mineral) të jenë të certifikuara dhe të përshtatshme për përdorim në shtresa rrugore me ngarkesë trafiku.

Kërkesat mbi temperaturën e prodhimit dhe transportit të asfaltobetonit janë të domosdoshme për ruajtjen e parametrave fizikë dhe për garantimin e ngjeshjes optimale gjatë shtrimit. Mosrespektimi i këtyre parametrave çon në ulje të cilësisë së shtresës, deformime të parakohshme dhe kosto shtesë mirëmbajtjeje.

Parashikimi i kontrollit laboratorik dhe testimeve në përputhje me standardet përkatëse garanton verifikimin e vazhdueshëm të cilësisë së materialit dhe përputhshmërisë me specifikimet teknike. Dokumentimi i transportit dhe gjurmueshmëria e ngarkesës sigurojnë transparencë dhe kontroll teknik gjatë gjithë procesit.

Gjithashtu, kërkesa për vënie në funksion të fabrikës edhe për sasi të vogla prodhimi lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të mirëmbajtjes dhe ndërhyrjeve emergjente. Riparimet e gropave dhe dëmtimeve të rrugës kërkojnë reagim të menjëhershëm për të garantuar sigurinë rrugore dhe për të shmangur përkeqësimin e mëtejshëm të shtresës ekzistuese. Organizimi i prodhimit në orët e vona të natës përbën një masë tekniko-organizative për të reduktuar ndikimin në trafikun urban dhe për të shmangur bllokimet në rrugët e brendshme të qytetit.

Në tërësi, specifikimet teknike të përcaktuara përfaqësojnë kërkesa minimale të domosdoshme për realizimin korrekt, të sigurt dhe cilësor të punimeve objekt kontrate, duke siguruar mbrojtjen e investimit publik dhe përputhshmërinë me standardet teknike dhe legjislacionin në fuqi.

NJËSIA E PROKURIMIT